



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**RREGULLORE DIPLOMIMI E PROGRAMEVE STUDIMORE**  
**TË CIKLIT I – BACHELOR**

- ✓ Bachelor në Gjuhë Angleze me profile; *Gjuhë Angleze, Përkthim dhe Interpretim, Studime Britanike dhe Amerikane*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Frënge me profile; *Gjuhë dhe Komunikim, Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez, Përkthim dhe Interpretim*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Gjermane me profile; *Gjuhë dhe Komunikim, Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Gjermanishtfolës, Përkthim dhe Interpretim*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Italiane me profile; *Gjuhë dhe Komunikim, Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Italian, Përkthim dhe Interpretim*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Turke me profile; *Gjuhë, letërsi dhe Qytetërim Turk, Përkthim dhe Interpretim*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Ruse me profile; *Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Rus, Përkthim dhe Interpretim*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Spanjolle me profil: *Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik*
- ✓ Bachelor në Gjuhë Greke me profile; *Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Grek, Përkthim dhe Interpretim*

**Miratuar me Vendimin e Dekanatit**

**Nr. 32 datë 18.03.2022**



## **NENI 1**

### **Objekti**

Rregullorja e diplomimit të programeve studimore të ciklit të parë Bachelor ka për qëllim mbështetjen e organizimit të efektshëm të procedurave të përgatitjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të detyrimit përmbyllës.

Rregullorja e Diplomimit Cikli I në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve të përfshira në procesin e diplomimit, të cilat përcaktojnë të drejtat e detyrimit e studentëve, rregullat për organizimin e procesit si edhe raportet e tyre me organet drejtuese dhe strukturat e tjera të FGJH-së.

Rregullorja ka për qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit të diplomimit, të sigurojë rregulla të njëjta për disiplinën studentore dhe administrative, si edhe të garantojë standarde të cilësisë në detyrimin përmbyllës me provim përfundimtar apo hartimin e tezës së diplomës të ciklit të parë.

## **NENI 2**

### **Baza Ligjore**

Kjo rregullore është hartuar bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr 80/2015, Statutin e Universitetit të Tiranës, Rregulloren e Universitetit të Tiranës.

## **NENI 3**


### **Parakushte të marrjes së temës së Diplomës**

Parakusht për fitimin e Diplomës së Ciklit të parë të studimeve në të gjitha programet studimore “Bachelor” të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja është shlyerja nga studentët e të gjitha detyrimeve të lëndëve, sipas parashikimeve në planin mësimor të programit të studimit.

## **NENI 4**

### **Fusha e Veprimit**

Rregullorja shtrin efektet e saj në të gjitha strukturat, organet dhe autoritetet drejtuese të njësisë kryesore, njësitë bazë përbërëse, personelin akademik, personelin jo akademik dhe studentët.



Kjo Rregullore është hartuar në përputhje me planin mësimor të programit të studimit duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e stafit akademik, të studentëve dhe të legjislacionit në fuqi.

## NENI 5

### Mbrojtja e diplomës

1. Përmbyllja e detyrimeve të programit të studimeve të ciklit të parë, bëhet sipas parashikimit në planin mësimor të programit të studimit:
  - a) me provim të përgjithshëm përfundimtar, ose
  - b) me punim diplome.
2. Detyrimi përmbyllës i programit të studimeve të ciklit të parë sipas veçorive të secilit program studimi, përlllogaritet nga 3% deri në 5% të krediteve në total, ose 75-125 orë punë e pavarur e studentit, e cila parashikohet në planin mësimor.
3. Mbrojtja e diplomës (me provim të përgjithshëm përfundimtar, ose me punim diplome) bëhet në 3 (tri) sezone: sezoni i dimrit, sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës. Afatet e mbrojtjes, përcaktohen nga drejtuesi i njësisë kryesore.
4. Kandidati diplomant në ciklin e parë të studimeve, i cili rrëzohet në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm.
5. Hartimi i programit (syllabusit) të provimit të formimit për programin e studimit bëhet nga njësia bazë dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë përgjegjëse.

## NENI 6

### Detyrimi përmbyllës me provim përfundimtar

1. Detyrimi përmbyllës me provim përfundimtar për ciklin e parë të studimeve është në formën e një eseje argumentuese e cila hartohet me (+/- 10% 1250 fjalë).
2. Provimi përfundimtar për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë të Huaj” me profil “Gjuhë, letërsi dhe qytetërim” si edhe “Gjuhë dhe komunikim” zhvillohet në këtë formë:
  - a. Studentëve iu dërgohen programet përkatëse të hartuara nga pedagogët e lëndëve sipas fushave përkatëse për secilin profil studimi në fillim të semestrit të dytë.
  - b. Gjithashtu iu dërgohen modele të eseve të viteve të mëparshme apo udhëzime *ad hoc* për hartimin e eseve në varësi të specifikave të programit të studimit të secilës njësi bazë.




- c. Studentët përgatiten për programet e ofruara nga secila njësi bazë, ku, ditën e provimit, iu jepet e drejta për të përzgjedhur njërën prej temave të esesë të propozuara për provim.
3. Provimi përfundimtar për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë Angleze” me profile “Gjuhë angleze” si edhe “Studime britanike dhe amerikane” zhvillohet në këtë formë:
  - a. Studentëve iu dërgohen modulet dhe temat përkatëse në fillim të semestrit të dytë për të studiuar dhe thelluar njohuritë më tej.
  - b. Ditën e provimit përfundimtar studentët do të shkruajnë 3 (tri) ese formuese, (+/- 10% 500 fjalë secila ese) duke përzgjedhur 3 (tre) module.
4. Provimi përfundimtar për programin e studimit Bachelor në “Gjuhë e Huaj” me profil “Përkthim dhe Interpretim” përbëhet prej këtyre komponentëve:
  - a) një ese (+/- 10% 350 fjalë) me një temë që përzgjidhet ditën e provimit nga lënda *Teori përkthimi*, programi i së cilës iu dërgohet studentëve në fillim të semestrit të dytë. Po kështu, iu dërgohen edhe udhëzimet për hartimin e esesë;
  - b) përkthimi i një teksti të përgjithshëm dhe/ose terminologjik A-B dhe/ose B-A secili nga 150 fjalë;
  - c) një provë interpretimi simultan dhe/ose konsektiv B-A;
  - d) provim në lëndën e përkthimit dhe të krahasimit të përkthimit;
  - e) përllogaritja e notës së marrë në lëndën e përkthimit në rastet kur nuk parashikohet nga njësia bazë komponenti i parashikuar në pikën b apo c.
5. Secila njësi bazë parashikon në rregulloren e saj të programit të studimit/e diplomimit specifikat për zhvillimin e provimit përfundimtar si edhe mënyrën e vlerësimit të provimit për secilin komponent të parashikuar.
  - a) Vlerësimi i detyrimit përmbyllës me provim përfundimtar bëhet në përputhje me *Shtojcën nr. 2* të kësaj Rregulloreje. Vlerësimi përfundimtar është në përputhje me *Shtojcën nr. 5* të kësaj rregulloreje. Si rregull, bazohet në: vlerësimin e provimit përfundimtar 60% e notës përfundimtare) si edhe notën mesatare të tri viteve të studimit (40% e notës përfundimtare).

## NENI 7

### Detyrimi përmbyllës me tezë diplome

1. Sipas veçorive të programit të studimit dhe kapaciteteve të njësisë përgjegjëse, punimi i diplomës mund të jetë me karakter teorik ose eksperimental, në përputhje me Udhëzuesin e Punimit të Temës së Diplomës (*Shtojca nr.1*).



2. Udhëzuesi i Punimit të Temës së Diplomës (*Shtojca nr. 1*), është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje e cila miratohet me vendim dekanati.
3. Studentët zgjedhin pedagogun udhëheqës si edhe fushën e studimit në muajin dhjetor pranë njësive përkatëse. Në muajin shkurt depozitojnë pranë njësisë bazë temën dhe abstraktin e punimit. Në përfundimit të semestrit të dytë, pasi kanë marrë miratimin e udhëheqësit për mbrojtje, dorëzojnë punimin me shkrim në 2 (dy) kopje si edhe në format cd pranë njësive përkatëse.
4. Mbrojtja e punimit bëhet para komisioneve përkatëse të ngritura nga përgjegjësi i njësisë bazë. Komisioni përbëhet nga 3 (tre) pedagogë të fushës së studimit, ku njëri prej tyre është udhëheqësi i punimit.
5. Vlerësimi i punimit me shkrim “Tezë Diplome” bëhet në përputhje me (*Shtojcën nr. 3*) të kësaj Rregulloreje. Vlerësimi përfundimtar i detyrimit përmbyllës është në përputhje me *Shtojcën nr. 4* të kësaj rregulloreje. Si rregull, bazohet në: vlerësimin e provimit përfundimtar 60% e notës përfundimtare) si edhe notën mesatare të 3 (tri) viteve të studimit (40% e notës përfundimtare).

**DEKAN**

**Prof.Dr. Esmeralda KROMIDHA**



## **Shtojca nr. 1.**

### **Udhëzuesi i Punimit të Temës së Diplomës për ciklin e parë të studimeve (Bachelor)**

#### **1. Struktura e temës**

Tema e diplomës duhet të përbëhet nga këto pjesë:

- Ballina/Kopertina. Ballina e temës duhet të ketë këto elementë: logo e Universitetit të Tiranës, logo e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, titulli i punimit, emri i studentit dhe i pedagogut.
- Përmbajtja. Jep informacion rreth strukturës së punimit, por gjithashtu ndihmon që të gjenden lehtë titujt e punimit. Titujt e kapitujve dhe nënkapitujve duhet të shoqërohen me numrat progresiv përkatës të faqeve.
- Hyrja. Është pjesa e fillimit të temës. Në hyrje duhet të përshkruhen qartë argumenti i temës së diplomës, arsyet e përzgjedhjes së saj si dhe struktura e punimit.
- Pjesa qendrore e temës. Është pjesa e temës në të cilën trajtohet në mënyrë të detajuar argumenti i përzgjedhur. Mund të përbëhet nga një apo disa kapituj dhe duhet të përmbajë: bazën teorike të objektit të studimit; zhvillimin e temës; argumentimin dhe analizën kritike të temës; përshkrimin e procedurës së punës si dhe metodat dhe instrumentet e përdorura; paraqitjen dhe diskutimin e rezultateve të arritura.
- Përfundimet. Në këtë pjesë rimerren problemet që përbëjnë bazën e studimit dhe përmbledhen rezultatet më domethënëse të arritura për të treguar se çfarë risish ka sjellë kjo temë për audiencën.
- Bibliografia. Vendoset në fund të dokumentit dhe liston referencat e përdorura në punim.

Web – referencat paraqiten në një zë të veçantë të titulluar Sitografia. Referencat dhe bibliografia renditen alfabetikisht. Referimi i literaturës duhet të përfshijë të gjitha informacionet e nevojshme për të gjetur dokumentin e treguar.


Shembuj referimi:

CALVANI A., Elementi di didattica. Problemi e strategie, Carocci, Roma 2000.

- Shtojca. Është pjesë fakultative, jo e detyrueshme e temës. Në të përfshihen tabelat përmbledhëse, grafikët, të dhënat e plota të analizuara etj.

#### **2. Gjatësia e temës**

Punimi do të ketë një gjatësi minimale të detyrueshme prej 30 000 karakteresh.



### **3. Formatimi i temës**

- Margjinat (Layout Page): ana e majtë duhet të jetë 3,8cm ( "1.5 ), pasi kjo është ana që duhet lidhur, ndërsa ana e djathtë dhe dy anët e tjera: lart, poshtë 2.54 cm ( "1 ).
- Lloji i gërmës (Font): duhet të jetë Times New Roman, madhësia 12 pt për tekstin, 14 për titujt.
- Paragrafët: hapësira mes rreshtave duhet të jetë 1,5 radhë (1.5 line spacing).
- Numrat e faqeve: duhet të vendosen në këndin e poshtëm të djathtë të faqes. Numërimi fillon me pjesën e hyrjes dhe përfundon në faqen e fundit të temës.
- Shënimet në fund të faqes (Footnote): duhet të vendosen automatikisht në mënyrë elektronike me gërmë Times New Roman dhe madhësi 10 pt.

### **4. Gjuha e hartimit të temës**

Tema do të hartohet në gjuhën shqipe ose në gjuhën e huaj B të studentit, në varësi të specifikave të secilit departament.



**Shtojca nr. 2**

**FLETË VLERËSIMI**

**PËR “PROVIMIN PËRFUNDIMTAR” NË PROGRAMIN E STUDIMIT “BACHELOR”  
NË “GJUHË E HUAJ”, me profil : (emërtimi i plotë i programit të studimit)**

Emri i studentit: \_\_\_\_\_

Nr.	Kriteret e vlerësimit të esesë	Pikët e parashikuara	Pikët e fituara
1	Shpalosja e problematikës	10	
2	Konceptimi dhe origjinaliteti i qasjes	20	
3	Koherenca dhe argumentimi i çështjes	20	
4	Cilësia e të shkruarit dhe respektimi i strukturës së esesë	10	
	<b>SHUMA E PIKËVE</b>	<b>60/60</b>	

Komisioni i vlerësimit:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_ / \_\_\_ /2022





**Shtojca nr. 3.**

**VLERËSIMI**

**PËR PUNIMIN ME SHKRIM "TEZË DIPLOME" NË PROGRAMIN E STUDIMIT  
"BACHELOR"**

**NË "GJUHË E HUAJ", me profil : (emërtimi i plotë i programit të studimit)**

Emri i studentit: \_\_\_\_\_

Titulli i temës së punimit: \_\_\_\_\_

<b>Nr.</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Pikët e parashikuara</b>	<b>Pikët e fituara</b>
1	Originaliteti i punimit (formulimi origjinal i temës, këndvështrimi origjinal i temës, struktura origjinale, analiza origjinale);	10	
2	Shpalosja e problematikës, konceptimi dhe koherenca;	10	
3	Cilësia e të shkruarit dhe respektimi i stilit shkencor të të shkruarit dhe i rregullave të drejtshkrimit);	5	
4	Paraqitja teknike (respektimi i kërkesave teknike të formatit të punimit).	5	
	<b>SHUMA E PIKËVE</b>	<b>30/30</b>	

Komisioni i vlerësimit:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Datë \_\_\_ / \_\_\_ /2022



Shtojca nr. 4.

**FLETË VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR**

**PËR DETYRIMIN PËRMBYLLËS ME “TEZË DIPLOME” NË PROGRAMIN E STUDIMIT “BACHELOR”**

**NË “GJUHË E HUAJ”, me profil : (enërtimi i plotë i programit të studimit)**

Nr.	Emri i studentit	Titulli i temës së punimit Në gjuhën B	Vlerësimi i punimit me shkrim të diplomës 30%/100%	Vlerësimi i prezantimit me gojë 30%/100%	Mesatare 40 %/100%	Vlerësimi përfundimtar	
						Pikët	Nota
1							
2							
3							

Komisioni i vlerësimit:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /2022



**FLETË VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR**

**PËR DETYRIMIN PËRMBYLLËS ME “PROVIM PËRFUNDIMTAR”NË PROGRAMIN E STUDIMIT “BACHELOR”  
NË “GJUHË E HUAJ”, me profil : (emërtimi i plotë i programit të studimit)**

Nr.	Emri i studentit	Vlerësimi i provimit përfundimtar 60 % / 100%	Mesatare 40 %/100%	Vlerësimi përfundimtar	
				Pikët	Nota
1					
2					
3					

Komisioni i vlerësimit:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

Date \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ /2022

